



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 132, dt. 03.07.2015

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore", i ndryshuar, bazuar dhe në rregulloren "Mbi kriteret dhe procedurat administrative për marrjen e licensave të ushtrimit të profesionit të restauratorit", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 03.07.2015, pasi shqyrtoi kërkesën për shtesë drejtuesi teknik në licensën e restaurimit R.SH.10 të shoqërisë "AD-STAR", në restaurimin e veprave të artit dhe objekteve muzeale të z. Mustafa Arapi me licensë R.P.45,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e shoqërisë "AD-STAR" sh.p.k me licensë në fushën e restaurimeve R.SH.10 me drejtues ligjor z. Alfred Çomo, për të shtuar si drejtues teknik në shoqërinë e tij, z. Mustafa Arapi, i pajisur me licensë R.P.45, në restaurim e veprave të artit dhe objekteve muzeale për kategoritë B/1 dhe B/2.
2. T'i propozojë Ministrisë së Kulturës, shtimin e drejtuesit teknik në licensën e fushës së restaurimit për kategorinë C, " Punime restaurimi në monumentet e arkitekturës për shoqëri ndërtimi në restaurimin e monumenteve të trashëgimisë së arkitekturës" të shoqërisë së ndërtimit "AD-STAR" sh.p.k me drejtues teknik restaurator z. Mustafa Arapi.
3. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI